

„Kompetent gjuhësor që nga fillimi“ – Fleta udhëzuese U7 Këshilla për praktikimin e shumëgjuhësisë në familje

Të dashur prindër,

me 2 vite, zhvillimi gjuhësor i fëmijës Tuaj qëndron në plan të parë. Ai në asnjë fushë nuk bën aq përparime sikur gjatë mësimit të gjuhës.

Në vazhdim i keni disa këshilla se si ta mbështetni fëmijën Tuaj në zhvillimin gjuhësor dhe si t’ia bëni me kuptim dhe të zbatueshëm praktikimin (kontaktin) me gjuhë të ndryshme.

Nëse fëmija Juaj deri më tani është rritur pothuajse vetëm me gjuhën e familjes

■ *Me fëmijën Tuaj flisni edhe më tej në gjuhën Tuaj amtare.*

Fëmija Juaj së shpejti do ta flasë shumë mirë gjuhën e parë dhe me këtë ai do të ketë kushte shumë të mira parapra-ke për mësimin e një gjuhe të dytë.

■ *Shfrytëzoni më shpesh rastet në të cilat fëmija Juaj do të vijë në kontakt me gjuhën gjermane.*

Vizitoni të paktën një herë në javë një grup të fëmijëve, ku flitet gjermanisht. Do të ishte edhe më mirë sikur fëmija Juaj të mund të shkojë rregullisht në një çerdhe/kopsht fëmijësh. Atje fëmijët shumë më shpejt e mësojnë gjermanishten.

■ *Mos u shqetësoni nëse fëmija Juaj në fillim bën edhe më shumë gabime në gjermanisht.*

Kjo është krejtësisht normale. Me zgjerimin e njohurive të gjermanishtes, fëmija Juaj do të mund t’i shqiptojë më mirë fjalët, do ta rrisë leksikon (vokabularin) dhe do ta përmirësojë gramatikën.

Në qoftë se fëmija Juaj rritet me më shumë gjuhë

■ *Mos u bëni merak nëse fëmija Juaj i përziën gjuhët.*

Përzjerja e gjuhëve ndodh shumë shpesh te fëmijët që flasin më shumë gjuhë. Në ato raste fjalët dhe format gramatikore të cilat në njërin gjuhë ende nuk zotërohen në mënyrë perfekte, zëvendësohen me ato fjalë dhe

forma të gjuhës tjetër. Më vonë si zakonisht gjuhët përzihen vetëm atëherë kur gjatë një bisede të gjithë personat flasin gjuhë të ndryshme. Kjo më parë tregon se fëmija Juaj shumë mirë mund t’ia dalë mbanë me më shumë gjuhë.

■ *Nëse asnjëra prej gjuhëve nuk është gjermanisht, fëmijës Tuaj duhet t’i mundësoni kontakte me gjermanishten.*

Fëmija Juaj shumë më thjeshtë e mëson gjermanishten kur ai është bashkë me fëmijët që flasin gjermanisht. Në veçanti do të ishte e favorshme vizita e hershme e një çerdheje ose një kopshti fëmijësh, kështu që fëmijës Tuaj për çdo ditë i shtohen shanset për mësimin e gjuhës gjermane.

A flet fëmija im shumë pak?

Fëmijët e mësojnë gjuhën mesatarisht shpejt. Përderisa disa fëmijë arrijnë t’i shqiptojnë 100 – 200 fjalë dhe të formojnë fjali të vogla, fëmijët tjerë i shqiptojnë vetëm pak fjalë. Kjo ndodh pavarësisht nga ajo se një fëmijë rritet me një ose me më shumë gjuhë.

Me 24 muaj fëmijët duhet t’i flasin (shqiptojnë) të paktën 50 fjalë. Kjo mund të zgjasë pak më shumë te mësimi i njëkohshëm i më shumë gjuhëve dhe kjo është krejtësisht normale. Në qoftë se lidhur me zhvillimin gjuhësor shfaqet pasiguri dhe shqetësim, atëherë bisedoni me mjekun (pediatrin) Tuaj. Me atë rast mjeku p.sh. mund t’ju sqarojë se fëmija Juaj a mund dëgjojë si duhet, dhe t’ju japë këshilla për hapat e mëtejshëm.

Pra, fëmija Juaj mund ta bëjë këtë

Nga moshë 24. muajshe 1 flet të paktën 50 fjalë

Krijoni fjali të vogla, si: „Hajde në gjumë – nina-nina“

Kështu pra mund ta mbështetni fëmijën Tuaj në zhvillimin e gjuhës

■ *Kapni/ndiqni shprehjet jo të plota të fëmijës Tuaj.*

Kur fëmijët fillojnë t’i formojnë fjalitë e para, ata bëjnë më shumë gabime. Kjo është krejtësisht normale. Ju mund ta ndihmoni/mbështetni fëmijën Tuaj, ashtu që fjalitë e tija jo të plota t’ia përsëritni edhe një herë në mënyrë korrekte. Me atë rast fëmija Juaj gëzohet, ngel i motivuar dhe kalimthi e dëgjon fjalinë e saktë.

Ja 2 shembuj lidhur me këtë:

Kapni/ndiqni shprehjet fëmijërore dhe përsëritni ato në një fjali.

Fëmija: „Vetura.“ **Prindi:** „Po, një veturë. Vetura ecën.“

Gabimet përmirësoni indirekt përmes përsëritjes korrekte.

Fëmija: „Vetula/Xina ec.“ **Prindi:** „Saktë, vetura ecën.“

Është me rëndësi që fëmijën Tuaj të mos e urdhëroni t’i përsërisë fjalët ose ta kritikoni atë.

■ *Kontribuoni që fëmija Juaj gjatë bisedës të ndjejë kënaqësi.*

Fëmijët tani do t’i gëzojë sidomos loja me gishta dhe këngët lëvizëse p.sh. „Kjo është e drejtë dhe kjo është e shtrembër“.

■ *Me fëmijën Tuaj vështroni librat e fëmijëve me ilustrime dhe lëreni atë që ai të sqarojë gjithë atë çka e sheh në një faqe.*

Sidomos, librat pa tekst janë ideale për familjet ku praktikohet shumëgjuhësia.

■ *Për ta mësuar gjuhën, fëmijët kanë nevojë për kontakte të drejtpërdrejta me të rriturit dhe fëmijët e tjerë.*

Shikimi/ndjekja e emisioneve televizive gjermane nuk janë të mjaftueshme për mësimin e gjuhës.